REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

P R O J E K T V E N D I M

Nr. _____, Datë _____._____.2018

"PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT, "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.07.2008, "PËR TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR "

Në mbështetje të neneve 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës, me propozim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare" të ndryshuar, për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit shoqërues që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

ARBEN AHMETAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

P R O J E K T L I G J

Nr. _____/2018, datë _____/____2018

"PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.07.2008, "PËR TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar bëhen ndryshimet dhe shtesa si vijon:

Neni 1

Në nenin 3, "Llojet e taksave kombëtare", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Pikat 8 dhe 8/1, riformulohen si vijon:

  "*8. Taksa e materialeve plastike dhe e ambalazheve prej plastike/qelqi.*".

  "8/1. Material plastik konsiderohen mallrat e importuara sipas Kodit 39 të NKM".

- Pas pikës 8/1 shtohet pika 8/2, me këtë përmbajtje:

  "*8/2. Ambalazh plastik/qelqi, është çdo material paketues, që shërben për paketimin e produkteve, i cili mund ta mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë, dhe e mbron produktin nga ndotja, infeksionet, nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij, dhe që e bëjnë të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipa ambalazhesh.*".

Neni 2

Në nenin 4 "Niveli i Taksave Kombëtare" bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Në pikën “4” në paragrafin e parë dhe në paragrafin e tretë, togfjalëshi “*në masën sa 1/2 e normës së rentës*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*në masën sa 1/3 e normës së rentës*”.

- Pika “8” ndryshon me këtë përmbajtje:
  “8. Taksa e materialeve plastike dhe e ambalazheve plastike të importuara në Kodin 39 të NKM, është 35 lekë/kg, me përjashtim të granulatit të importuar në kodet 3901, 3902, 3903, dhe 3904 të NKM.”.
  8.1 Taksa e granulatit të importuar në kodet 3901, 3902, 3903, dhe 3904 të NKM-së, dhe që përdoret për prodhimin në vend të produkteve të plastikës, është 25 lekë/kg.
  8.2 Taksa e ambalazheve të qelqit është 10 lekë/kg dhe zbatohet për ambalazhet e qelqit të importuara dhe të prodhuara në vend. Taksa zbatohet për të gjithë artikujt prej qelqi sipas kreut 7010 të NKM-së, në rast se ambalazhi importohet veçmas, si dhe kur materiali i qelqit zë, të paktën, 80 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.
  8.3 Në rastin e importit, taksa e: materialeve plastike; granulatit për prodhimin e materialeve plastike, si dhe e ambalazheve prej plastike/qelqi llogaritet dhe mblidhet nga Administrata Doganore në momentin e importit.
  8.4 Në rastin e prodhimit brenda vendit, taksa e ambalazheve prej qelqi, mblidhet nga Administrata Tatimore sipas afateve dhe procedurave të deklarimit në këtë ligj. Administrata Tatimore monitoron dhe kontrollon lëndët e para që përdoren për prodhimin e ambalazheve të qelqit, si dhe granulatin e importuar me qëllim prodhimin e materialeve dhe ambalazheve plastike brenda vendit.”.

Neni 3

Në nenin 5 “Agjentët e taksave” shkronja “ë”, riformulohet me këtë përmbajtje:

“ë) për taksën e materialeve plastike dhe taksën e ambalazheve prej plastike/qelqi”:

i) Administrata Doganore në rastet e importit të materialeve plastike ambalazheve prej plastike/qelqi”;

ii) Administrata Tatimore në rastet e prodhimit brenda vendit të ambalazheve prej qelqi”.

Neni 4

Në nenin 8 “Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave”, shkronja “e” riformulohet si më poshtë:

“e*) për taksën e materialeve plastike dhe ambalazheve prej plastike/qelqi, 0 për qind*”.

Neni 5

Në nenin 9 “Përjashtimet nga pagimi i taksave kombëtare”, në pikën 4, fjalia e parë, riformulohet me këtë përmbajtje:

"*4.Përjashtohen nga pagimi i taksës së materialeve plastike dhe ambalazheve prej plastike/qelqi, sipas nenit 4*".

Neni 6

Në shtojcën nr. 2 "Renta minerare sipas klasifikimit", përqindja e rentës minerare, në grupin e parë (I) "Mineralet metalike", në pikën 4 "Mineralet e kromit për eksport", bëhet 9 %.".

Neni 7

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në 01 janar 2019.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI